

TË ARDHURA QË LULËZOJNË

Investoni në fondin që vë
në lëvizje kursimet tuaja

Raport Muaji Dhjetor 2023

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Datë Lancimi	01 Mars 2012
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	5,000
Shuma minimale pasuese	1,000

Komisionet dhe Tarifat

Tarifë në hyrje	0%
Tarifë në dalje	0%
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.15% e vleres neto te aseteve
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Referojuni prospektit te fondit
Komisione/tarifa e vazhdueshme	1.27% per vitin 2022
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	Referojuni informacionit ne deget e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizojë kthimin nga investimi, duke synuar në të njëjtën kohë ruajtjen e kapitalit të investitorit dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm.

Asetet e fondit janë të investuara në bono thesari dhe obligacione të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Fondi është i përshtatshëm për individë dhe subjekte juridike të cilët mendojnë se objektivi i investimit i Fondit përputhet me kërkesat dhe pritshmëritë e tyre.


Shifra e tarifës së vazhdueshme 1.27% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2022. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.4% ne vit te vlerës neto të aseteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi Raiffeisen Prestigj është në kategorinë e dytë të Profilit të Riskut dhe Perfitimit.

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.


Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 31.12.2023

Vlera Neto e Aseteve	31,024,815,016
Numri i investitoreve	25,813
Cmimi i Kuotes	1,612.7591
*Kthimi vjetor neto nga investimi (31.12.2022 – 31.12.2023)	6.78%

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 31 Dhjetor 2023



Në kuadër të politikës së investimit të fondit Prestigj, investimet do të kryhen kryesisht në bono dhe obligacione thesari, të emtuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar apo transaksioneve në tregun sekondar. Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy herë në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një herë në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një herë në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një herë në 2 muaj për secilin maturitet.

Instrumenti

Ne % te Aseteve te Fondit

Marreveshje të Anasjellta të Ribletjes – Rev Repo	6.26%
Depozita & Llogari rrjedhese	10.16%
Bono Thesari	20.44%
Obligacione Thesari	63.14%

Strategjia e investimeve është e fokusuar në tituj të Qeverisë Shqiptare, por përveç këtyre investimeve, Fondi mban një pjesë të asetëve në depozita afatshkurtra për të plotësuar në çdo kohë nevojat për likuiditet të investitoreve.

Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 31 miliardë në datë 31 Dhjetor 2023.


Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Dhjetor

Ne Dhjetor norma bazë e interesit eshte e pandryshuar në nivelin 3.25%. Norma e inflacionit u rrit ne 4.00%, krahasuar me muajin Nentor qe ishte 3.90%.

Asetet e Fondit Prestigj jane te investuara vetem ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe per kete arsye fondi eshte i ekspozuar ndaj ndryshimeve ne normat e interesit te ketyre titujve.

Normat e interesit te titujve te emetuar nga Qeveria Shqiptare kane ndjekur nje trend pergjithesisht rrites pergjate muajit Dhjetor, pervec yield-it të Bonos se Thesarit 12-mujore i cili rezultoi ne 3.362%, duke rene me 0.05% krahasuar me ankandin e muajit Nentor. Per sa i perket obligacioneve, yieldi i obligacionit 2 vjeçar rezultoi ne 4.23%, duke u rritur me 0.05% krahasuar me ankandin paraardhes dhe yield i obligacionit 7 vjeçar rezultoi ne 5.96%, duke u rritur me 0.33% krahasuar me ankandin paraardhes. Ankandi i obligacionit reference 3-vjeçar rezultoi ne 5.053%, duke u rritur me 0.12% krahasuar me ankandin e fundit, ndersa ankandi i obligacionit reference 5-vjeçar rezultoi ne 5.652%, duke u rritur me 0.25% krahasuar me ankandin e fundit.

Grafiket me poshte japin nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Dhjetor 2022 – Dhjetor 2023. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yield-et fikse te perlllogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Dhjetor.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri ne 31 Dhjetor 2023

Kthimi vjetor neto per periudhen 31 Dhjetor 2022 – 31 Dhjetor 2023 eshte 6.78%.

Çmimi i kuotes se fondit Prestigj ne muajin Dhjetor ka rene me **-0.08%**.


Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet e normave te interesit te titujve te borxhit te emetuar nga Qeveria Shqiptare. Keshtu kur normat e interesit ne treg rriten, vlera e titujve te portofolit ulet dhe per rrjedhoje ulet dhe norma e kthimit per periudhen e kaluar. E kunderta ndodh kur normat e interesit ulen. Per pasoje, çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem. Luhatshmeria eshte pjese e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.

Ecuria e çmimit të kuotës Fondi Raiffeisen Prestigj



Ne dt. 31 Dhjetor 2023	1 Vit	2 Vjet	3 Vjet	5 Vjet	7 Vjet	10 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (1 Mars 2012)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	6.78%	1.21%	1.61%	1.52%	2.23%	3.46%	4.12%

Kthimi vjetor historik i Fondit Raiffeisen Prestigj per çdo vit



Investitorët e fondit Prestigj dhe të gjithë fondëve të administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të përfituar një kthim optimal nga investimi dhe në këtë mënyrë në periudhë afatmesme apo afatgjatë të kenë mundësi të rikuperojnë edhe efektet negative të krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond, sepse në këtë mënyrë nuk do të rrezikojnë të dalin nga fondi në momentin e gabuar për investimin e tyre.

Të dhënat për kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjere numerike, janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen INVEST sh.a., në website www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.